

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6530
E martë, 8 shkurt 2022
çmimi 0.40 €

Kushtetuesja përfundon
seancën për shkarkimin e
Metës, vendimi pas 30 ditësh

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

DËSHTON MBLEDHJA E KRYESISË SË KUVENDIT TË KOSOVËS | FAQE 4-5

KOMPENSIMI I SHPENZIMEVE PËR UDHËTIME PËRPLAS LDK-në ME LV-në



Kompensimi financiar i deputetëve për udhëtimet në seanca është bërë sepse për një përplasje të fortë në mes të shefit të grupit parlamentar të LDK-së, Arben Gashi, dhe shefit të kabinetit të kryeparlamentarit Glauk Konjufca, Ilir Kërçeli. Fjalosja në mes tyre ka bërë që të ndërpritet mbledhja e Kryesisë së Kuvendit. Pas ndërprerjes së mbledhjes, Konjufca ka thënë se Gashi ka kërcënuar shefin e stafit të tij, duke përdorur gjuhë të rëndë ndaj tij. Deputeti i LDK-së ka mohuar pretendimet e kryeparlamentarit

AKTUALE



JOHNSONI DËSHIRON T'I OFROJË
RUSISË GARANCI PËR NATO-n | F. 2

MJEKËSIA E PUNËS, DREJT
SHUARJES | F. 7

KOMUNA E SKENDERAJT NIS
HARTIMIN E RREGULLORES SË RE | F. 6

EKONOMI



RRETH 30 PËR QIND
E SHPENZIMEVE BUXHETORE
SHKOJNË PËR PAGA | F. 8

TAKOHET GRUPI PUNUES
PËR STIKERSAT, SË SHPEJTI
NËNSHKRUHET MEMORANDUMI | F. 8

SPORT



KIANA KRYEZIU, E 49-ta NË 'PEKINI
2022': NIVELI I GARËS ISHTE MË I
LARTI QË EKZISTON | F. 10

Aktakuzë ndaj dy
zyrtarëve të
"Hidrodrinit" për
helmimet në Deçan

FAQE 3



TETË TË VDEKUR BRENDË
24 ORËVE, IKSHPK-JA THOTË SE
GJENDJA MUND TË PËRKEQËSOHET
NË DITËT E ARDHSHE

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Johnsoni dëshiron t'i ofrojë Rusisë garanci për NATO-n



LONDËR, 7 SHKURT - Kryeministri britanik Boris Johnson dëshiron t'i ofrojë Rusisë garanci rreth rolit të NATO-s, sepse kjo aleancë është mbrojtëse dhe çdo demokraci evropiane duhet të lejohet që t'i bashkohet, deklaroi zëdhënësi i tij. Rusia, që ka aneksuar Gadishullin ukrainas të Krimesë më 2014, po kërkon garanci të sigurisë, që përfshin edhe zotimin që NATO nuk do ta pranojë kurrë Ukrainën. "Rusia ka shprehur shqetësime lidhur

me agresionin e mundshëm nga NATO, por ne kemi qenë të qartë se këto shqetësime janë thellësisht të pabazuara, pasi NATO është aleancë mbrojtëse. Por, ne duam të punojmë me Rusinë dhe t'i ofrojmë garanci diplomatike për këtë çështje. Nuk bëhet fjalë për bërje koncesionesh, pasi kryeministri [britanik, Boris Johnson] dhe liderët e tjerë kanë thënë se të gjitha demokracitë evropiane kanë të drejtë t'i bashkohen NATO-s,

tha zëdhënësi i kryeministrit Johnson.

Rusia ka grumbulluar mbi 100 000 trupa ruse përgjatë kufirit me Ukrainën, që nga Perëndimi po shihet si përgatitje për një pushtim të mundshëm të Ukrainës.

Rusia mohon se ka plane për ta pushtuar Ukrainën, por ka kërkuar nga NATO dhe Shtetet e Bashkuara garanci ligjore se aleanca nuk do ta pranojë Kievin si dhe të mos zgjerohet në drejtim të lindjes.

Otava shpall gjendje të jashtëzakonshme

OTAVË, 7 SHKURT - Kryetari i kryeqytetit të Kanadasë, Otava, ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme, pas një jave të protestave të shoferëve të kamionëve, kundër kufizimeve për luftim të pandemisë.

Jim Watson ka thënë se qyteti është "plotësisht jashtë kontrollit" dhe se numri i protestuesve është më i madh sesa i zyrtarëve policorë. Sipas tij, protestat përbëjnë kërcënim për sigurinë e banorëve.

Qendra e Otavës është paralizuar, pasi rrugët janë bllokuar nga makinat dhe tendat.

Fushata "Konvoji i Lirisë" ka nisur pas prezantimit të

rregullave të reja kundër pandemisë për shoferët e kamionëve. Sipas këtyre rregullave, të gjithë shoferët e kamionëve duhet të jenë të vaksinuar për ta kaluar kufirin mes Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë.

Pas publikimit të rregullit, protestat janë përhapur edhe kundër kufizimeve të tjera për luftim të pandemisë.

Kryetari i qytetit nuk ka dhënë hollësi specifike se çfarë masash mund të marrë, mirëpo policia ka thënë se do ta rrisë sigurinë, duke përfshirë edhe arrestimin e mundshëm të atyre që mbështesin protestuesit duke u dërguar naftë dhe ushqime.



Australia hap kufijtë për të vaksinuarit



CANBERRA, 7 SHKURT - Australia ka njoftuar se do t'i rihapë kufijtë e saj për turistët e vaksinuar dhe personat e tjerë që kanë viza, për herë të parë në gati dy vjet. "Nëse jeni të vaksinuar plotësisht, mezi ju presim sërish", ka thënë kryeministri Scott Morrison. Rihapja, që do të ndodhë më 21 shkurt, do të mirëpritet nga shumë sektorë, përfshirë edukimin ndërkombëtar. Australia ka zbatuar disa prej

masave më të rrepta kufitare gjatë pandemisë së koronavirusit.

Në mars të vitit 2020 qeveria ka mbyllur kufijtë.

Shumicës së të huajve u është ndaluar hyrja me qëllim të luftimit të pandemisë.

Morrison ka thënë se ata që hyjnë në Australi duhet të kenë dëshmi të vaksinimit.

"Ky është rregulli. Secili duhet ta zbatojë atë", ka shtuar ai.

Udhëtarët e pavaksinuar, të

cilët kanë arsye shëndetësore pse nuk janë imunizuar, duhet të sigurojnë përjashtim nga rregulli i vaksinimit, dhe nëse ia dalin, duhet t'i nënshtrohen masës së karantinës.

Sipas të dhënave të Universitetit "Johns Hopkins", autoritetet australiane kanë regjistruar më shumë se 2.7 milionë raste me koronavirus dhe 4 248 viktima.

Rreth 80 për qind e popullsisë është e vaksinuar plotësisht.

Izraeli nuk kërkon më pasaportë të vaksinës

JERUSALEM, 7 SHKURT - Izraeli ka anuluar kërkesën e dëshmisë së vaksinimit për koronavirus pavarësisht prej shifrës rekorde të personave të sëmurë nëpër spitale.

Prej të hënës, 7 shkurt, njerëzit do të duhet të vërtetojnë se kanë qenë të vaksinuar apo janë shëruar, duke treguar "pasaportën e gjelbër", vetëm kur marrin pjesë në ngjarje të

mëdha, siç janë martesat.

Kjo nënkupton se secili mund të shkojë në restorant, kinema dhe hotele, pa pasur nevojën e prezantimit të dëshmisë së testit negativ në koronavirus.

Ky ndryshim i rregullave nënkupton se kur njerëzit e pavaksinuar largohen nga Izraeli, nuk duhet të tregojnë se janë negativë në këtë virus.

Ky lehtësim vjen pavarësisht

faktit që më shumë se 1 200 persona të infektuar me koronavirus janë nëpër spitale. Kjo është shifra më e madhe e të hospitalizuarve që prej shpërthimit në pandemisë, në këtë shtet me 9.4 milionë banorë.

Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, aktualisht 1 235 pacientë janë të sëmurë rëndë në Izrael.



Tetë të vdekur brenda 24 orëve, IKShPK-ja thotë se gjendja mund të përkeqësohet në ditët e ardhshme

Kosova ka regjistruar tetë viktime dhe 754 raste të reja me Covid-19. Sipas njoftimit të Ministrisë së Shëndetësisë (MSh), rastet e reja dolën pas testimit të 3 879 mostrave. Nga kjo shifër del se 19.43 për qind e të testuarve kanë rezultuar pozitivë me Covid-19. Në raportin që u referohet të dhënave të 24 orëve paraprake, MSh-ja ka njoftuar se janë shëruar edhe 3 900 pacientë, ndërkaq raste aktive me Covid janë 23 823

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 SHKURT - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se nga 3 879 testime, 754 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar edhe tetë raste të vdekjes. Të hënën janë shëruar edhe 3 900 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 191 408.

Në total numri i rasteve aktive është 23 823.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 146 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 793 236 doza të vaksinës. Deri më sot 808 328 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Deri më sot janë dhënë 88 988 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.

Bazuar në raportet e datës 7 shkurt nga klinikat Covid-19 në QKUK dhe spitalet e përgjithshme, në trajtim mjekësor janë 229 pacientë nga Covid-19. "156 pacientë janë me oksigjenoterapi, në Mjekim Intensiv janë 20 pacientë", ka

njoftuar Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës përmes një komunikate për medie ka theksuar se varianti Omicron po vazhdon të përhapet me intensitet të lartë, me shtim të hospitalizimeve dhe rasteve fatale. Sipas IKShPK-së, varianti dominues Omicron po rëndon gjithnjë e më tepër situatën epidemiologjike dhe mund t'i ngarkojë institucionet shëndetësore në ditët në vijim me pasoja të rënda për shëndetin e qytetarëve. "Virusi është kudo andaj mos neglizhoni rekomandimet themelore: maskën, distancën, higjienën. Shmangni udhëtimet, qëndroni në shtëpi dhe ajrosni ambientet e mbyllura. IKShPK-ja është duke vazhduar pandërprerë me testimin dhe gjurmimin e të gjitha rasteve, kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik andaj të gjithë personat me kokëdhembje, kollitje, dhembje fyti, vështirësi në frymëmarrje, rrjedhje hundësh, temperaturë, plogështi, humbje të shijes, rekomandohen të

testohen", thuhet në komunikatën e këtij instituti. Sipas IKShPK-së, situata epidemiologjike mund të përkeqësohet edhe më shumë në ditët në vazhdim. Andaj IKShPK-ja apelon te të gjithë qytetarët që të respektohen masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Na ndihmoni që t'ju ndihmojmë! Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të përhapjes së Covid-19, bëjmë thirrje në veçanti për kujdes dhe mosgrumbullim. Ndërsa rekomandojmë institucionet përgjegjëse të mbikëqyrin me përpikëri dhe të ndërmarrin të



gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e masave për parandalimin dhe luftimin e pandemisë", ka njoftuar IKShPK-ja në komunikatën për medie.

Qeveria e Kosovës ka miratuar më 4 shkurt masat e reja kundër Covid-19. Ora policore do të fillojë nga ora 00:00 deri në orën 05:00, ndërsa gastronomia do të punojë deri në orën 23:00. Sipas ministrit të Shëndetësisë, Rifat Latifi, ndryshime do të ketë në masat lidhur me personat që hyjnë në Kosovë për kufizimin e lëvizjes dhe punën e bizneseve. "Kemi vendosur lehtësimin gradual të

masave që mundësojnë një aktivitet të shtuar ekonomik, njëkohësisht synojmë ta ngadalësojmë infektimin", ka thënë Latifi në një konferencë për medie.

Në masat e reja është thënë se personat që hyjnë në Kosovë duhet ta kenë certifikatën e vaksinimit të plotë me të dyja doza, ose vaksinimin me një dozë së bashku me një test negativ PCR. Sipas masave të miratuara, bartja e maskës, duke mbuluar hundën dhe gojën, është obliguese në të gjitha rastet në ambientet e mbyllura.

Aktakuzë ndaj dy zyrtarëve të "Hidrodrinit" për helmimet në Deçan

PEJË, 7 SHKURT (ER) - Prokuroria Themelore në Pejë ka ngritur aktakuzë ndaj dy zyrtarëve të kompanisë rajonale 'Hidrodrini' lidhur me helmimin e mbi 1 500 qytetarëve të Deçanit dhe fshatrave përreth në korrik të vitit të kaluar.

Prokurori i rastit, Dorjan Juniku, ka thënë se drejtori teknik i "Hidrodrinit" dyshohet për veprën penale "shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm" dhe kimistja e kësaj kompanie dyshohet për veprën penale "mosevitim i rrezikut". "Në rastin konkret është e vërtetë se mbi 1 500 persona kanë kërkuar ndihmë mjekësore, mirëpo 872 kanë pasur simptoma që u referohen helmimeve nga uji i pijshëm, për çka edhe nga raporti gastroenteriti epidemiologjik i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike është konstatuar se të njëjtit kanë pasur bakterie Escherichia Coli dhe bakterin e njohur si Novo Virus",

ka deklaruar Juniku.

Ai ka shtuar se në ujë ka pasur mungesë të klorit dhe se kompania "Hidrodrini" nuk ka bërë testime të rregullta për cilësinë e ujit. Në korrik të vitit të kaluar, mbi 1 500 persona në Deçan dhe dhjetë fshatra përreth kishin kërkuar ndihmë mjekësore në Qendrën e Mjekësisë Familjare për shkak se kishin simptoma të helmimit. Prokurori Juniku tha se në mesin e personave që kërkuar ndihmë ishin edhe 51 fëmijë.

Pas rritjes së numrit të pacientëve që kërkonin ndihmë mjekësore, autoritetet lokale të Deçanit kishin rekomanduar qytetarët që të mos e përdornin për pije ujin e ujësjellësit në këtë komunë. Për më tepër, komuna e Deçanit kishte njoftuar se ka nisur hapa për të themeluar një ndërmarrje të re komunale, me qëllim që të shkëputet nga "Hidrodrini". "Hidrodrini", përveç Deçanit, furnizon me ujë edhe Pejë, Istogun, Klinën dhe Junikun.





DËSHTON MBLEDHJA E KRYESISË SË KUVENDIT TË KOSOVËS

Kompensimi i shpenzimeve për udhëtime përplas LDK-në me LV-në

Kompensimi financiar i deputetëve për udhëtimet në seanca është bërë sebeb për një përplasje të fortë në mes të shefit të grupit parlamentar të LDK-së, Arben Gashi, dhe shefit të kabinetit të kryeparlamentarit Glauk Konjufca, Ilir Kërçeli. Fjalosja në mes tyre ka bërë që të ndërpritet mbledhja e Kryesisë së Kuvendit. Pas ndërprerjes së mbledhjes, Konjufca ka thënë se Gashi ka kërcënuar shefin e stafit të tij, duke përdorur gjuhë të rëndë ndaj tij. Deputeti i LDK-së ka mohuar pretendimet e kryeparlamentarit

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 7 SHKURT - Përplasja për kompensimet e deputetëve për udhëtimet në mes të shefit të grupit parlamentar të LDK-së, Arben Gashi, dhe shefit të kabinetit të kryeparlamentarit Glauk Konjufca, Ilir Kërçeli, ka bërë që të ndërpritet të hënën mbledhja e Kryesisë së Kuvendit. Pas ndërprerjes së kësaj mbledhje, kryeparlamentari Glauk Konjufca ka thënë se deputeti Gashi ka kërcënuar shefin e stafit të tij. "Mbledhja e sotme nuk do të mbahet për shkak të kërcënimeve të shefit të LDK-së, Arben Gashit, drejtuar stafit tim. Kjo gjuhë është e papranueshme. Shprehjet që i përdor ai janë të papranueshme. Këto sjellje

nuk duhet t'i pranojmë. Ishte skandalozë gjuha e tillë, sepse është shumë ofenduese me sharje familjare", ka thënë Konjufca në një konferencë për medie.

I pari i Kuvendit ka paralajmëruar marrjen e masave disiplinore ndaj deputetit Gashi. "Do të shohim masat që do t'i marrim dhe masat disiplinore që kemi në Kuvendin e Republikës së Kosovës, pastaj me një kërkim falje që është më e pakta që duhet të ndodhë në këtë rast", ka thënë Konjufca.

Pretendimet e kryetarit të Kuvendit i ka hedhur poshtë deputeti i LDK-së, Arben Gashi. Ai ka thënë se mbledhja e kryesisë ka dështuar pasi kryeparlamentari ka bërë shkelje. "Mbledhja e Kryesisë ka dështuar për shkak se

kryetari i Kuvendit kishte marrë me vete shefin e kabinetit, i cili ka bërë shkelje të detyrave dhe përgjegjësisë të veta. Ne kërkuam që ai të mos ishte prezent dhe kryetari nuk pranoi një gjë të tillë. Shefi i kabinetit, përveçse ka thënë të pavërteta, ka përdorur të vërteta të pjesshme, duke tentuar të denigrojë deputetë të caktuar të Kuvendit të Kosovës", ka thënë Gashi. Ai ka deklaruar se ka mbajtur distancë me shefin e kabinetit të kryeparlamentarit. "Nuk e kam prekur me dorë, sepse kemi pasur distancë me të. Nuk është e vërtetë. Kryetari duhet të jetë në krye të detyrave të tij dhe jo ta aktivizojë shefin e kabinetit të tij që të keqpërdorë informacione të pasakta në dëm të deputetëve", ka

vlerësuar Gashi.

Versionin e tij për ngjarjen e ka dhënë edhe deputeti i LV-së, Adnan Rrustemi. Sipas tij, deputeti i LDK-së kishte sjellje joparlamentare. "Ne do të kërkojmë që Kuvendi ta rishikojë vendimin e vitit 2011. Ne jemi të bindur se ky kompensim është i tepërt për deputetët. Nuk kompensohen shpenzimet e derivateve. Ne jemi për rregullim të përhershëm. Deputetët mos ta kenë pjesë të pagës kompensimin e udhëtimit", ka deklaruar Rrustemi.

Debatit në mes të Gashit dhe Kërçelit ka filluar kur ky i fundit, një ditë më parë, ka thënë se një deputet i LDK-së nga viti 2011 deri në vitin 2013 ka shpenzuar derivate 10 440 euro. Më pas ka reaguar deputeti i LDK-së, duke thënë se kompensimet për udhëtim i ka marrë vetëm në mandatin e parë. "Në atë kohë për pjesën dërrmuese të deputetëve apo ata që jetonin jashtë kryeqytetit, Sekretariati i Kuvendit të Kosovës kishte vlerësuar se duhet t'u paguhen shpenzimet e udhëtimit.

Thënë të drejtën, asokohe as nuk e dija që na takonte një gjë e tillë, gjë që e kam kuptuar me shumë muaj vonësë. Mirëpo, nga mandati im i dytë e tutje unë jetoj në Prishtinë. Dhe nga dita ime e parë e mandatit tim të dytë, e kam njoftuar Sekretariatit e Kuvendit të Kosovës që tash e tutje jetoj në kryeqytet dhe se normalisht lirohem nga pagesa e udhëtimit", kishte shkruar Gashi në profilin e tij në "Facebook".

Ditët e fundit janë publikuar të dhënat për disa deputetë të Kuvendit të Kosovës, ku gjatë muajit nëntor dhe dhjetor të vitit të kaluar kanë bërë shpenzime të mëdha të karburantit për të shkuar në seancë dhe në komisione. Për dy muaj një nga deputetët ka shpenzuar 870 euro për karburante.

Ndër deputetët që kanë shpenzuar më së shumti janë: Pal Lekaj, Yllëza Hoti, Hajdar Beqa, Armend Zemaj, Gramos Agusholli, Agon Batusha, Duda Balje, Albana Bytyqi, Artan Abrashi, Fatmire Kollcaku, Haxhi Avdyli dhe Mërgim

Kushtetuesja përfundon seancën për shkarkimin e Metës, vendimi pas 30 ditësh

Tiranë, 7 shkurt - Gjykata Kushtetuese të hënën ka përfunduar seancën. Në këtë seancë është shqyrtuar kërkesa e Kuvendit të Shqipërisë për shkarkimin e presidentit Ilir Meta. Nga ky moment, Gjykata Kushtetuese ka 30 ditë kohë për ta dhënë vendimin. Seanca për presidentin ishte shtyrë për këtë javë, pas kërkesës së përfaqësuesve të presidentit, të cilët kërkuan kohë që t'i paraqitnin argumentet e tyre pas 70 pyetjeve të drejtuar kësaj pale nga trupi gjykuës i Kushtetueses.

Ekipi ligjor i presidentit Meta ka paralajmëruar se po përgatit një pađi

lidhur me, siç tha, manipulimet e dokumenteve të Kuvendit.

Në seancën e fundit, përfaqësuesit e presidentit kundërshtuan procedurën që ishte ndjekur nga Parlamenti për ngritjen e komisionit hetimor për shkarkimin e kreut të shtetit, duke argumentuar se ngritja e vet komisionit ishte shkelje e Kushtetutës.

Deputetët e Partisë Socialiste kishin themeluar një komision hetimor për ta hetuar presidentin Meta për shkeljen e Kushtetutës para dhe gjatë fushatës zgjedhore të zgjedhjeve qendrore në prill të vitit 2021.

Deputetët, pas gjetjeve të komisionit,

më 9 qershor të vitit 2021, kanë votuar në favor të shkarkimit të presidentit me 104 vota, duke thënë se ai ka shkelur Kushtetutën e Shqipërisë dhe se "me veprimet, sjelljet dhe mesazhet e dhëna në publik nuk ka garantuar unitetin kombëtar, nuk ka moderuar konfliktin politik, por përkundrazi e ka nxitur atë në terma të tilla, të cilat sollën si pasojë daljen e organizuar të militantëve të partive politike në rrugë duke terrorizuar qytetarët, duke kufizuar lirinë e tyre të lëvizjes si dhe lirinë personale, deri në kryerjen e konflikteve me armë".

Neni 90 i Kushtetutës së Shqipërisë e

parashih shkarkimin e presidentit nga Kuvendi për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë. Sipas këtij neni, propozimi për shkarkimin e presidentit në raste të tilla mund të bëhet nga të paktën një e katërta e anëtarëve të kuvendit apo 35 deputetë nga 140 sa i ka Kuvendi i Shqipërisë.

Presidenti Meta ka thënë se nuk do të njohë asnjë veprimtari të një kuvendi "njëpartiak" dhe se do ta ushtrojë detyrën e tij deri më 24 korrik të vitit 2022. Ai këtë deklaratë e bëri pasi shkarkimi i tij u votua në një kohë kur opozita e Shqipërisë kishte djegur

mandatet e veta në Kuvend.

Ato (mandatet) ishin zëvendësuar nga një opozitë tjetër, nga persona të partive përkatëse, por që nuk kishin marrë votat e mjaftueshme për t'u bërë deputetë në zgjedhje. Në rast të një shkarkimi të mundshëm, Meta automatikisht nuk mund të ushtrojë më asnjë kompetencë dhe rolin e tij e merr kreu i Kuvendit.

Meta është zgjedhur president më 28 prill 2017 me 87 vota, me mbështetjen e Partisë Socialiste dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim, të cilën e drejtonte vetë Meta. Mandati i presidentit është pesëvjeçar dhe roli i tij është kryesisht protokollar.



Lushtaku.

Aktualisht në legjislaturën e tetë të Kuvendit janë 67 deputetë të cilët kanë të regjistruar vendbanimin jashtë

Prishtinës dhe prej tyre 36 janë nga Lëvizja Vetëvendosje.

Më 10 tetor 2011 kryetari i Kuvendit të atëhershëm, Jakup Krasniqi, kishte nënshkruar një

vendim në të cilin thuhet se kompensohen shpenzimet për udhëtim të deputetëve për seanca plenare të cilët janë regjistruar me vendbanimin

jashtë Prishtinës. Sipas këtij vendimi, deri në 30 kilometra deputeti kompensohet me 10 euro, deri në 60 kilometra me 20 euro, mbi 60 kilometra me

30 euro. Pas një reagimi të fortë qytetar, deputetët e LV-së kanë vendosur që vullnetarisht më të mos i marrin këto kompensime.

Drejtoresha Krasniqi viziton dy shkolla në Malishevë, njoftohet me gjendjen në arsim

MALISHEVË, 7 SHKURT (ER) - Drejtoresha e Drejtorisë për Arsim dhe Edukim në komunën e Malishevës, Arbëreshë Krasniqi, në kuadër të vizitave në shkolla, të hënën i ka vizituar shkollat në fshatrat Bellanicë dhe Astrazup, ku është njoftuar nga afër me gjendjen e përgjithshme në këto shkolla. Përfaqësues nga kjo drejtori kanë theksuar se qëllimi i këtyre vizitave është njoftimi me gjendjen e përgjithshme në shkolla, duke filluar nga njoftimi për nevojat që kanë shkollat e deri te cilësia në mësimdhënie, higjiena, si dhe gjendja me pandeminë Covid-19. Drejtoresha Krasniqi është njoftuar me gjendjen në këto dy shkolla, nga ana e përgjegjësve të tyre, si dhe i ka vizituar edhe klasat ku mbahet mësimi, ku është takuar me nxënës

dhe me mësimdhënës. “Ju përgëzoj për punën që bëni dhe profesionin fisnik që keni. Ju siguroj se përkrahja nga ana e drejtorisë nuk do të mungojë asnjëherë, por kërkoj edhe më shumë angazhim nga ju për arritjen e rezultateve dhe sukseseve nga puna juaj që bëni me nxënësit”, ka thënë drejtoresha Krasniqi gjatë takimeve me mësimdhënës në këto shkolla. Drejtoresha Krasniqi ka bërë me dije se vizita të tilla do të bëhen në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të cilat janë përgjegjësi e drejtorisë që ajo drejton dhe qëllim i këtyre vizitave është njohja me gjendjen në shkolla dhe ofrimi i mbështetjes për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në të gjitha shkollat, gjithmonë brenda kompetencave që ka drejtorja.



Komuna e Skenderajt nis hartimin e rregullores së re



SKENDERAJ, 7 SHKURT (ER) - Në kuadër të takimit të rregullt javor të drejtorëve komunalë në Skenderaj, krahas detyrave dhe obligimeve të secilës drejtori, në mbledhjen e mbajtur të hënën është marrë vendim për t'i nisur procedurat lidhur me hartimin e rregullores së re për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba. Kryetari i komunës, Fadil Nura, ka thënë gjatë takimit se ky dokument është ndër më të rëndësishmit që përcakton politikën zhvillimore të komunës. Veç kësaj, në takim është marrë vendim të nisin procedurat edhe për plotësimndryshimin e statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në qytetin e Skenderajt. Me këtë rast, kryetari Nura ka theksuar nevojën për një hap të tillë, me qëllim që të fillojnë


reformat në shëndetësi, ndërsa ka shtuar se ato janë edhe objektive e qeverisjes aktuale në Skenderaj. Gjatë fazave të mëtejme, siç premtoi kryetari Nura, do të ftohën edhe komuniteti i biznesit, shoqëria civile dhe grupet e tjera të interesit që ta japin kontributin e tyre dhe të bëhen pjesë e vendimmarrjes sonë të përbashkët. Tema të tjera të diskutuara në këtë takim kanë qenë detyrat javore të drejtorive dhe angazhimet e përbashkëta të qeverisjes lokale në funksion të ngritjes së mirëqenies dhe shërbimeve ndaj qytetarëve. Nura dhe nënkryetari Lushtaku kanë kërkuar nga drejtorët angazhim të vazhdueshëm për t'i përmbushur pritjet e qytetarëve si dhe është kërkuar respektim më i madh i orarit të punës zyrtare.

Shipoli së shpejti do të bëhet me çerdhe moderne për fëmijë

MITROVICË, 7 SHKURT (ER) - Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit, Elvis Feka, së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Edison Tërnavë, të hënën kanë vizituar çerdhën publike e cila është duke u ndërtuar në Shipol të Mitrovicës. Përmes kësaj vizite ata kanë parë për së afërmi punimet të cilat

janë duke u zhvilluar për ndërtimin e kësaj çerdhe, për të cilën kanë planifikuar buxhet shtesë për këtë vit në mënyrë që punimet të arrijnë në fazën finale. Kjo çerdhe publike e cila është në ndërtim e sipër do të jetë institucioni më modern i këtij lloji në Mitrovicë, që do të shërbejë më shumë për banorët

e Shipolit. Çerdhja ndodhet në një lokacion të përshtatshëm, ku në afërsi të saj ndodhet edhe shkolla fillore, si dhe qendra e mjekësisë familjare. Tërnavë ka thënë se çerdhja do t'i përmbushë sadopak nevojat dhe kërkesat e qytetarëve për kujdes ndaj fëmijëve për prindërit të cilët kanë nevojë për kujdes ditor të fëmijëve të tyre.



Në Rahovec vazhdon largimi i deponive ilegale të mbeturinave



RAHOVEC, 7 SHKURT (ER) - Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtorja për Shërbime Publike, përmes operatorëve ekonomikë po vazhdon mirëmbajtjen e hapësirave publike duke eliminuar të gjitha deponitë ilegale të mbeturinave.

Për mirëmbajtjen e hapësirave publike, drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, Përparim Krasniqi, është shprehur se janë duke vazhduar mirëmbajtjen e hapësirave publike, duke eliminuar të gjitha deponitë ilegale të mbeturinave. “Apeloj te të gjithë që mos të hedhin

mbeturina vend e pa vend, pasi që hedhja e mbeturinave në vendet ku është e ndaluar, do të gjobiten nga institucionet komunale dhe Policia e Kosovës. Komuna e Rahovecit synon të jetë komunë ekologjike”, ka thënë drejtori Krasniqi.

Mjekësia e punës, drejt shuarjes

PRISHTINË, 7 SHKURT - Nga rreth 4 800 mjekë sa ka Kosova, vetëm 20 janë të specializuar në mjekësinë e punës, ndërsa specializime për këtë degë nuk janë hapur për më shumë se dy dekada.

Kryetari i Odës së Mjekëve të Kosovës, Pleurat Sejdiu, ka thënë se katër mjekë të punës tashmë janë pensionuar dhe se shumica e të tjerëve janë në prag të pensionimit. "Kosova është prej vendeve të pakta në botë që nuk ka listë të sëmundjeve profesionale (sëmundjeve në vend të punës). Dhe kush do të ishin më të thirrur për t'u marrë me këtë çështje sesa mjekët e punës", ka thënë Sejdiu për "Radion Evropa e Lirë".

Mjekësia e punës fokusohet në ruajtjen e shëndetit të punëtorëve, duke përfshirë parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve dhe lëndimeve të tyre.

Sipas Inspektoratit të Punës në Kosovë, në vitin 2021 nëntë qytetarë kanë humbur jetën në vend të punës, 40 kanë marrë lëndime të rënda dhe 139 lëndime të lehta.

Në periudhën 2016-2020 74 qytetarë kanë vdekur në vend të punës, kurse 530 janë lënduar.

Qendra Kombëtare e Mjekësisë e Punës, e cila ka selinë në Gjakovë, funksionon tash për tash me vetëm një mjek të punës. Nga muaji mars rrezikon të mbetet me asnjë, ka thënë drejtori Luan Nagavci. "Për fat të keq, ky mjek që është tani, muajin tjetër pensionohet", ka bërë me dije ai.

Me situatë të ngjashme përballet edhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Prishtinë. Aktualisht, mjekë të punës aty janë dy. Njëra prej tyre Shpresa Kuqi. "Kemi qenë pesë, tre kolegë të mi kanë dalë në pension dhe



tash jemi dy. Unë jam deri në muajin gusht, ndërsa kolegu im do të vazhdojë disa muaj pas meje", ka thënë Kuqi, e cila detyrën e mjekës së punës e kryen qysh në vitin 1983.

Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", Kuqi ka treguar për rëndësinë që, sipas saj, ka mjeku i punës. Ai është përcaktues i aftësisë së punës për një punëtor, ka thënë ajo. "Unë mendoj se një person nuk duhet të punësohet dhe nuk ka të drejtë të punësohet pa e marrë një certifikatë se është në gjendje të mirë psikike, fizike

dhe mendore për të filluar një marrëdhënie pune", ka thënë Kuqi.

Ministria e Shëndetësisë e Kosovës ka bërë me dije se në konkursin e fundit të specializimeve, më 2020-2021, janë ndarë pesë vende për specializim në mjekësi të punës - të parat që nga koha e pasluftës. Specializimi në këtë degë zgjat katër vjet. "Specializantët kanë nisur programin e shkollimit specialistik në mars 2021. Do të ndaheshin edhe më shumë vende sigurisht, por interesimi i mjekëve

ka qenë për kaq vende", është thënë në një deklaratë të Ministrisë së Shëndetësisë dërguar "Radios Evropa e Lirë". Specialisti i mjekësisë familjare, Sami Uka, ka thënë se prej vitit 2000 e këndeje autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë bërë përpjekje që mjekësinë e punës ta përfshijnë në kuadër të mjekësisë familjare. Sipas tij, kjo qasje është e gabuar sepse, siç thotë, shëndeti profesional kërkon angazhimin e mjekëve specifikë, me përgatitje të veçantë për sëmundjet e mjedisit punues

dhe për kushtet e punës që duhen ofruar. "Kohën e fundit kjo është një nevojë e shtuar, pasi vazhdimisht kemi probleme specifike të punëtorëve, jo vetëm probleme shëndetësore, por edhe vdekje si pasojë e mungesës së kushteve higjienike dhe kushteve adekuate të punës. Është koha që të mendohet seriozisht për këtë profil, që ka ekzistuar në të kaluarën", ka thënë Uka.

Pse është e rëndësishme mjekësia e punës?

Naim Bajraktari udhëheq një kompani në Prishtinë, e cila merret me vlerësimin e sigurisë në punë. Ai ka thënë se punëdhënësit e vuajnë mungesën e mjekëve të punës. "Kur zbulohen dëmtuesit apo mundësitë e rrezikut në një vend pune, ai që përcakton shkallën e rrezikshmërisë, është specialisti i mjekësisë së punës. Ne si ekspertë të sigurisë në punë mund të jemi inxhinierë, juristë apo biologë, por nuk jemi mjekë. Ne nuk dimë se me çfarë masash dhe me çfarë duhet të trajtohen punëtorët", ka thënë Bajraktari për "Radion Evropa e Lirë".

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, objektiva të mjekësisë së punës janë: ruajtja dhe promovimi i shëndetit të punëtorëve, përmirësimi i kushteve të punës dhe mjedisit të punës, si dhe zhvillimi i organizimit të punës dhe kulturave të punës. Sipas OBSH-së, çdo vit 12.2 milionë njerëz, kryesisht në vendet në zhvillim, vdesin nga sëmundje jo të transmetueshme, derisa janë ende në moshë aktive pune. OBSH-ja vazhdimisht u bënë thirrje vendeve që të zhvillojnë politika kombëtare dhe plane veprimi për shëndetin në punë.

Në 2021-n në spitalin e Gjakovës janë kryer 1 750 lindje



GJAKOVË, 7 SHKURT (ER) - Në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës gjatë vitit 2021 janë kryer 1 750 lindje, 528 me operacion. Përveç punës në Repartin e Gjinekologjisë, raportit vjetor i punës i ka përfshirë edhe rezultatet e

repartëve të tjera të cilat kanë ofruar mijëra shërbime për pacientët, me theks të veçantë sallat operative, ku u kryen 1 894 intervenime kirurgjike të natyrave të ndryshme. Vitin e shkuar në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës,

gjithashtu, janë realizuar 67 894 vizita ambulatorie dhe 468 119 analiza laboratorike për 29 627 pacientë. Nga shërbimet radiologjike, janë bërë 1 828 tomografi të kompjuterizuara, 9 026 ultrazë dhe 16 112 radiografi.a

Gjatë fundjavës policia arrestoi nëntë persona për vepra të ndryshme penale

PEJË, 7 SHKURT (ER) - Gjatë fundjavës në zonën e përgjegjësisë të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë janë arrestuar nëntë persona. Njësitë policore gjatë aktivitetëve në terren kanë sekuestruar një armë, një karikator dhe dy fishekë të kalibrit 7.65 mm, i

dyshuari është arrestuar për veprën penale "mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve", me vendim të prokurorit të shtetit është dërguar në mbajtje për 48 orë. Pesë persona janë arrestuar për veprën penale "lëndim i

lehtë trupor". Pas intervistimit, me vendim të prokurorit të shtetit, janë dërguar në mbajtje. Tre persona janë arrestuar për vepra të ndryshme penale me urdhëresë të gjykatës kompetente, për të vazhduar me procedura të mëtutjeshme ligjore.



Rreth 30 për qind e shpenzimeve buxhetore shkojnë për paga

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 SHKURT - Në kuadër të sezonit auditues 2021/2022, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është duke e kryer auditimin e teknologjisë së informacionit për Sistemin për Menaxhimin e Pagave në Thesarin e Kosovës. Sipas ZKA-së, ky sistem ka rol kyç në menaxhimin e pagave për të gjithë të punësuarit në sektorin publik në Republikën e Kosovës. “Rreth 30 për qind e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore të Republikës së Kosovës shkojnë për paga”, ka njoftuar ZKA.

Sipas këtij njoftimi, procesit të këtij auditimi do t'i nënshtrohet Thesari i Kosovës i cili funksionin në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. “Fokusi kryesor do të jetë në Divizionin e Menaxhimit të Pagave i cili është përgjegjës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Pagave si dhe departamente të tjera të ndërlidhura me procesin e pagave. Objektivi i këtij auditimi është të vlerësohet nëse ekziston një mjedis efektiv i

kontrollit që siguron se Sistemi për Menaxhimin e Pagave mbështet procesin e pagave si dhe ofron të dhëna të sakta, të besueshme, të tërësishme dhe në kohë. Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij Sistemi dhe Menaxhimin Efektiv të Procesit të Pagave, është e nevojshme që Thesari të ketë të vendosura strukturat, proceset dhe mekanizmat e nevojshëm që sigurojnë se Sistemi për Menaxhimin e Pagave (Payroll) mbështet procesin e pagave si dhe ofron të dhëna të sakta, të besueshme, të tërësishme dhe në kohë”, ka njoftuar ZKA-ja.

Ndërlidhur me këtë dhe bazuar në hulumtimet paraprake fushat të cilat do të trajtohen në këtë auditim janë: Qeverisja e TI-së që siguron nëse institucioni ka vendosur strukturat, proceset dhe ka identifikuar nevojat për funksionimin e sistemit; Operacionet e TI-së që sigurojnë se janë vendosur politikat e menaxhimit të ndryshmeve dhe ekziston struktura e nevojshme për vazhdimësinë të sistemit; dhe Kontrollat e aplikacioneve që sigurojnë se sistemi pranon të dhëna të sakta, të besueshme, të



tërësishme dhe në kohë. “Përmes auditimit të Sistemit për Menaxhimin e Pagave Zyra Kombëtare e Auditimit synon që të ofrojë rekomandime relevante për Ministrinë e

Financave, Punës dhe Transfereve, respektivisht Thesarin e Kosovës dhe përdoruesit e tjerë të sistemit në mënyrë që të përmirësohet qasja e tyre në raport me

menaxhimin, zbatimin dhe efikasitetin e këtij sistemi, si dhe ofrimin e informatave të sakta, të besueshme, të tërësishme dhe në kohën e duhur”, ka njoftuar ZKA-ja.

Takohet grupi punues për stikersat, së shpejti nënshkruhet memorandumi



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 SHKURT - Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), Sami Mazreku, është takuar të hënën në Prishtinë me zëvendësministrin e Infrastrukturës, Hysen Durmishi, shefin e kabinetit të guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës, Nexhat Miftaraj, si dhe Blerim Camajn, zëvendësues i drejtorit të Agjencisë së Regjistrimit Civil, me të cilët ka diskutuar rreth mbarëvajtjes së punëve të realizuara deri më tash për vendosjen e stikersave në xhamat e automjeteve. Gjatë takimit janë prezantuar

aspekti teknik, ai ligjor, por edhe detaje të tjera të cilat parashihen për zbatimin e këtij projekti i cili ka për qëllim uljen e numrit të automjeteve të paregjistruara në vend, e të cilat shkaktojnë humbje të konsiderueshme si për shtetin, ashtu edhe për industrinë e sigurimeve.

Gjatë ditëve në vijim palët janë marrë vesh të nënshkruajnë një memorandum të përbashkët në mënyrë që palët të jenë gati që nga 1 marsi i këtij viti të fillojë edhe në praktikë zbatimin e këtij projekti.

Vlen të theksohet se e gjitha barra financiare për zbatimin e këtij projekti shumë të rëndësishëm bie mbi Byronë Kosovare të Sigurimit.

Vendimi për blloktarifat pritët të merret para 20 shkurtit

PRISHTINË, 7 SHKURT - Kryesuesi i Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), Ymer Fejzullahu, ka thënë se ky institucion shumë shpejt pritët të marrë vendim për blloktarifat. Në një konferencë për medie ai ka thënë se

vendimi pritët të merret para datës 20 shkurt. “Ne jemi duke bërë përpjekje që vendimin ta marrim para datës 20 shkurt. Ky është një shqyrtim i jashtëzakonshëm dhe jemi të përkushtuar që ky proces të përfundojë sa më parë, duke

pasur parasysh se kemi kosto shtesë në sistem dhe domosdoshmërisht duhet të marrim një vendim që këto kosto të mbulohen sa më shpejt prej konsumatorëve, dhe në këtë rast edhe prej qeverisë”, ka thënë Fejzullahu.



Rreziku i luftës: A mund ta shmangë Evropa krizën energjitike?



Nga James McBRIDE
"Council on Foreign Relations"

Perspektiva e një sulmi të madh rus ndaj Ukrainës, ka shkaktuar shumë diskutime lidhur me varësinë evropiane ndaj energjisë ruse, si dhe ka nxiur një kërkim të ethshëm për alternativa. Kërcënimi i një pushtimi rus në shkallë të gjerë të Ukrainës, i ka vendosur pjesërisht Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tyre evropianë në një gatishmëri të lartë, për shkak të potencialit për ndërprerje të mëdha në tregun evropian të energjisë, i cili mbetet shumë i varur nga nafta dhe gasi rus.

Një sulm rus mund të shkaktojë anulimin e projekteve që janë në pritje të certifikohen, duke përfshirë gazsjellësin "Nord Stream 2" që çon gazin rus direkt në Gjermani, ndërsa presidenti rus Vladimir Putin ka kërcënuar të kufizojë eksportet e energjisë. Në përpjekje për ta zburuar një krizë të tillë, Shtëpia e Bardhë po përpjeket që t'i orientojë më shumë eksportet e saj energjitike drejt Evropës, por ekspertët thonë se çdo zgjidhje do të ketë një kosto jashtëzakonisht të lartë. Por cila është situata energjetike aktuale në Rusi? Ky vend është një gjigant në këtë fushë. Prodhuesi i tretë më i madh në botë i naftës, dhe prodhuesi i dytë më i madh i gazit natyror. Sipas disa vlerësimeve, lëndët djegëse fosile përbëjnë 14 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Të ardhurat nga ky sektor, garantojnë më shumë se 40 për qind të buxhetit federal. Gjatë viteve të fundit, Rusia i ka përdorur të ardhurat nga energjia për të grumbulluar rreth 630 miliardë dollarë rezerva valutore.

Për shembull, në vitin 2021 Kremlini e balancoi buxhetin e tij që kishte një pritshmëri relativisht të ulët, për shkak të çmimit të naftës prej 45 dollarësh për fuçi.

Në fakt vitin e kaluar çmimi ishte mesatarisht rreth 70 dollarë për fuçi. Siç e vë në dukje historiani i ekonomisë, Adam Tooze, kjo qasje konservatore fiskale, i ka dhënë mundësi Putin ta izolojë qeverinë e tij nga efektet e sanksioneve ekonomike të vendosura pas aneksimit të Krimesë nga Rusia në vitin 2014. Pjesa më e madhe e prodhimit energjetik të Rusisë, shkon për plotësimin e kërkesës evropiane, dhe sidomos për gaz që dërgohet nëpërmjet një rrjeti të ndërthurur në epokën sovjetike, që përkrahon Ukrainën dhe vendet e tjera të Evropës Lindore.

Por Moskë ka synuar të ndërtojë linja të reja të transportit, duke përfshirë "Nord Stream 2" që aktualisht ka shkaktuar shumë debate, për të anashkaluar rrjetet më të vjetra. Gjithashtu, ajo po mendon të ndërtojë një gazsjellës të ri për furnizimin e Kinës, edhe pse shitjet e tij ndaj këtij vendi fqinj, do të ishin sërish vetëm një pjesë e vogël në krahasim me sasinë e shitjeve në Evropë.

Por sa mbështetet Evropa mbi energjinë ruse? Në fakt ekziston një varësi e ndërsjellë: Kremlini varet nga të ardhurat që merr nga Evropa, ndërsa Evropa është e varur nga energjia ruse. Por shumë analistë thonë se kjo e fundit, nënkupton se vendosja e sanksioneve më të ashpra ndaj Rusisë, rrezikon që të dëmtojë seriozisht furnizimin e saj me energji.

Në përgjithësi, Rusia furnizon rreth një të tretën e konsumit evropian të gazit natyror, që

përdoret për ngrohje gjatë stinës së dimrit, por edhe për prodhimin e energjisë elektrike dhe prodhimin industrial.

Ndërkohë Bashkimi Evropian merr nga Rusia më shumë se një të katërtën e importeve të saj të naftës bruto, burimi i vetëm më i madh i energjisë për bllokun. Disa shtete të BE-së janë shumë më të varura se të tjerat.

Portugalia dhe Spanja përdorin pak nga energjia ruse, ndërsa Gjermania, ekonomia më e madhe në Evropë, merr nga Rusia më shumë se gjysmën e gazit natyror dhe më shumë se 30 për qind të furnizimeve të saj me naftë bruto.

Franca e garanton pjesën më të madhe të energjisë elektrike nga energjia bërthamore, por mbështetet sërish në importet ruse për të plotësuar nevojat e saj për lëndë djegëse fosile. Analistët thonë se planet e Gjermanisë dhe vendeve të tjera për të hequr dorë nga energjia bërthamore dhe qymyri, mund ta rrisin këtë varësi.

Si mund ta ndryshonte këtë marrëdhënie "Nord Stream 2"? Ky projekt është një zgjerim i gazsjellësit origjinal "Nord Stream", që përfundoi në vitin 2011 dhe që transporton gaz natyror nga Rusia Veriperëndimore përmes Detit Baltik direkt në Gjermani.

"Nord Stream 2" u miratua nga qeveria gjermane në vitin 2018, dhe ndërtimi i tij përfundoi në shtatorin e vitit 2021. Por vënia e tij në punë është përballur me vonesa nga entet rregullatore dhe nga tensionet në rritje midis Perëndimit dhe Rusisë.

Në rast se miratohet, ky gazsjellës do të lejojë që më shumë eksporte ruse të gazit natyror drejt Gjermanisë të anashkalojnë

Ukrainën dhe vendet e tjera tranzite. Ky projekt ka qenë që në fillim shumë i diskutueshëm. Kritikët, përfshirë Uashingtonin, kanë paralajmëruar se ai do t'i japë Moskës më shumë ndikim mbi vendet evropiane, dhe do të thellojë potencialisht ndarjet politike në kontinent mbi mënyrën se si duhet reaguar ndaj agresionit rus.

Ndërkohë, vendet e Evropës Lindore si Polonia dhe Ukraina, janë shumë të shqetësuara për shkak se "Nord Stream 2" do t'i privojë ato nga miliarda dollarë që merrin në formën e tarifave vjetore të tranzitit, dhe se ai do t'i lërë akoma më shumë në mëshirën e Rusisë.

Për shumë analistë, këto rreziqe u përforcuan sërish në fundin e vitit 2021, kur Rusia pezulloi furnizimin shtesë edhe pse kishte një rritje të kërkesës për energji. Rezultati ishte kërcënimet e mungesës në të gjithë Evropën. Për Francën, ai episodi konfirmoi se ishte e drejtë mbështetja e saj tek energjia bërthamore.

Çfarë do të ndodhë më pas? Udhëheqësit amerikanë dhe evropianë, janë shumë të shqetësuar mbi skenarin e ndërprerjes së madhe të furnizimeve energjetike, në rastin e një pushtimi rus në shkallë të plotë të Ukrainës. Qeveria gjermane ka thënë se nëse ndodh ky sulm, mund ta anulojë plotësisht "Nord Stream".

Megjithatë, një veprim i tillë do të përbente një sfidë të madhe: si të garantohet furnizimi i Evropës me karburant, duke e ndëshkuar në të njëjtën kohë Rusinë. Presidenti i SHBA-së, Joe Biden, ka premtuar t'i shkaktojë "kosto të rënda" Rusisë në rast se pushton Ukrainën, duke

përfshirë përjashtimin e bankave ruse nga sistemi financiar global. Por nëse Putin do t'i përgjigjet me ndërprerjen e furnizimit me gaz, kjo mund të rrisë akoma më tej çmimet e energjisë, të rrisë inflacionin, dhe të dëmtojë rimëkëmbjen ekonomike të Evropës. Prandaj aktualisht po bëhen përpjekje për të mbështetur nevojat evropiane për energji.

Evropa ka një rezervë strategjike për vetëm rreth 1 muaj, të cilën mund ta përdorë në rast urgjence. Për më tepër, ekziston një kërkesë e mjaftueshme për rreth 9 javë që zakonisht përballohet nga furnitorët tregtarë, ndërkohë Shtëpia e Bardhë po bën përpjekje për të grumbulluar furnizime shtesë të gazit natyror të lëngshëm (LNG). Një qasje e ngjashme ndihmoi në furnizimin e Japonisë pas katastrofës bërthamore të Fukushima në vitin 2011. Por analistët thonë se flitet për pjesën më të madhe të furnizimit në botë, dhe ndonëse masa të tilla mund ta lehtësojnë krizën në një periudhë afatshkurtër, koston do të jenë të larta.

Ekspertja e energjisë në Universitetin Tafts, Amy Myers Jaffe, thotë se në rastin e një ndërprerjeje të plotë të furnizimeve energjitike nga Rusia, ka të ngjarë që "Evropa të gjejë një rrugë" alternative. Jaffe thotë se prodhuesit mund të ridrejtojnë disa dergese për LNG ose të përdorin energjinë e qymyrit apo burimeve të tjera. Megjithatë, paralajmëron ajo "çdo ndryshim në krahun e ofertës do të vinte me çmime më të larta, duke i detyruar konsumatorët evropianë të përballen me një faturë edhe më të madhe".

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Kiana Kryeziu, e 49-ta në 'Pekini 2022': Niveli i garës ishte më i larti që ekziston

Skitarja e Kosovës, Kiana Kryeziu, dhe skitari Albin Tahiri kanë garuar të hënën në Lojërat Olimpikë Dimërore "Pekini 2022". Kiana zuri vendin e 49 nga 82 garuese në total, Tahiri përfundoi në vendin e 35-të nga 43 garues

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 SHKURT - Skitarja Kiana Kryeziu hyri në historinë e sportit të Kosovës si vajza e parë që garoi në Lojërat Olimpikë Dimërore "Pekini 2022". Skitarja 17-vjeçare debutoi të hënën në disiplinën e sllallomit të madh në LOD Pekini 2022. Ajo zuri vendin e 49 nga 82 garuese në total. Koha e saj pas dy lëshimeve ishte 2 minuta e 42.19 sekonda. Pavarësisht prej rezultatit, vetë kualifikimi në LOD Pekini 2022 është arritje e madhe për Kianën, e cila ka të ardhme të ndritur. Kiana pas garës ka thënë se niveli i kësaj gare ka qenë në nivelin më të lartë, prandaj është edhe e kënaqur edhe me rezultatit që e arriti. "Niveli i garës ishte më i larti që ekziston. Vetëm fakti që kam qenë në garë me idhujt e mi dhe garueset më të mira të botës e ka bërë këtë garë edhe më të mirë sesa që ishte. Ishte garë shumë e fortë dhe e vështirë, shumë sfiduese. Terreni ka qenë sfidues. Jam shumë e kënaqur që kam arritur ta jap maksimumin", ka thënë Kryeziu. Ndërsa skitari Albin Tahiri ka garuar në disiplinën e lëshimit në



skijimin alpin të Lojërave Olimpikë Dimërore "Pekini 2022". Tahiri përfundoi në vendin e 35-të nga 43 garues, pozita e tij më e mirë në Lojërat Olimpikë Dimërore. Atleti kosovar pati

kohën 1 minutë e 52.44 sekonda. Albini do të garojë edhe në disiplinën e kombinimit alpin, sllallomit dhe sllallomit të madh. Skitari Albin Tahiri është shprehur i kënaqur me atë se ka treguar në garën e parë. "Vendi i 35-të është më i miri në Lojërat Olimpikë deri tani, prandaj jam i kënaqur me rezultatit, por jo edhe me lëshimin. Pres më shumë në kombinimin alpin të enjten dhe shpresoj se do të përfundoj në top 30-she këtë herë", ka thënë Tahiri.

Gruaja e Valon Behramit fiton medaljen e bronzit olimpikë

Lara Gutt Behrami ka fituar medaljen e bronzit në disiplinën e sllallomit të madh në Lojërat Olimpikë Dimërore "Pekini 2022". Skitarja zvicerane është bashkëshortja e futbollistit me prejardhje nga Kosova, Valon Behrami. Në këtë disiplinë garoi sot edhe skitarja e Kosovës, Kiana Kryeziu, për të cilën Gutt Behrami është idhull i saj. Komiteti Olimpik i Kosovës përgëzon suksesin e Gutt Behramit, e cila vlerësohet favorite për të fituar medalje edhe në disiplinën e tjerë të skijimit alpin.



SHKURT

Llapi kualifikohet në çerekfinale

Skuadra e Llapit e ka siguruar kualifikimin në çerekfinale të Kupës së Kosovës, pasi e ka mposhtur Ferizajn me rezultat 0-2. Sulmuesi i njohur Alban Shillova e shënoi golin e parë për llapjanët nga penalltia në minutën e 30. Nëntë minuta më vonë Kastriot Selmani e realizoi golin e dytë për Llapin dhe të fundit në ndeshje. Në çerekfinale janë kualifikuar edhe Prishtina, Gjilani, Drita, Ballkani, Onixi, Ulpiana dhe Ramiz Sadiku.

Hajrizi, MVP në Superligën e basketbollit

Në xhiron e 19-të në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll janë zhvilluar disa ndeshje interesante, kurse sfida më interesante ishte në mes të Bashkimit dhe Trepçës, ku fitore shënuan mitrovicasit me shifrat 57:63. Basketbollisti më i dalluar në parket ishte Drilon Hajrizi me 21 pikë, dhjetë kërcime, katër asistime dhe një top të vjedhur. Gjuajtjet e tij të sakta për tri pikë ishin vendimtare në fitoren shumë të rëndësishme për "xehetarët". Kjo nuk është hera e parë që Hajrizi zgjidhet MVP i javës, duke qenë ndër më të merituarit, që skuadra mitrovicase po lufton për vendin e parë në elitë. Hajrizi është edhe pjesë e rëndësishme e Kosovës A në basketboll.

Të enjten shorti për çerekfinalen e Kupës në futboll

Të shtunën dhe të dielën janë zhvilluar ndeshjet e Kupës në futboll ku janë përcaktuar skuadrat çerekfinaliste. Shorti për këtë rreth, sipas Federatës së Futbollit të Kosovës, do të mbahet të enjten. "Komisioni i Garave ka vendosur që shorti për rrethin e çerekfinales së Kupës së Kosovës të mbahet të enjten (më 10 shkurt). Tërheqja e shortit bëhet në selinë e FFK-së në orën 13:00. Në këtë rreth të garave do të marrin pjesë tetë skuadra", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Mgbeike dallohet në derbi dhe zgjedhet MVP

Në fundjavë u zhvillua xhironja e 14-të në Superligën e femrave. Derbi ishte mes Prishtinës dhe Bashkimit, që përfundoi 97:74, ku prishtinaset regjistruan fitoren e 14-të nga po aq ndeshje të zhvilluara. Te kryeqytetaset u dallua Sarah Mgbeike me 19 pikë, 12 kërcime, gjashtë asistime, një top të vjedhur dhe një bllokadë, duke e pasur indeksin 35, apo më të lartin e ndeshjes. Kjo nuk është hera e parë që Mgbeike zgjedhet MVP në Superligën e Femrave. Ajo u ndihmua nga Tynice Martin me 28 pikë, katër kërcime dhe pesë asistime. Trepça shënoi fitore kundër Vëllaznimit, me shifrat 54:50. Te mitrovicasit u dallua braziliana Kelly Muller me 21 pikë, 21 kërcime dhe dy asistime. Ndërkohë, Penza, ashtu siç është pritur, mundi Kastriotin me rezultat bindës 20:150, ndërkohë që indeksin më të lartë të ndeshjes e kishin Rael Whitsitt dhe Diedona Halitaj. Amerikania Whitsitt u dallua me 16 pikë, 17 kërcime, 21 asistime dhe 12 topa të vjedhur, ndërsa Halitaj kontribuoi me 38 pikë, pesë kërcime, 11 asistime dhe 17 topa të vjedhur.

Daku transferohet te Mura

MURSKA SOBOTA, 7 SHKURT - Futbollisti Mirlind Daku është larguar nga skuadra e Osijekut dhe ka kaluar te Mura në Slloveni. Kalimi i ish-sulmuesit të Ballkanit në klubin sloven është në formë huazimi për

gjashtë muaj. "Mirlind Daku është lojtar i ri i Muras. Sulmuesi nga Kosova do të jetë huazim deri në fund të sezonit. Këtë vit ka zhvilluar 12 paraqitje për Osijekun, duke shënuar tri herë. Ka kontribuar me një gol në tri

ndeshje në kupë", thuhet në njoftimin e skuadrës së Murës. Ndërkohë, edhe nënpresidenti i Muras, Denis Rajbar, ka lavdëruar lart yllin e Kosovës. "Mirlind Daku është futbollisti që kemi ndjekur që një kohë të

gjatë. Numrat, sidomos në kampionatin e Kosovës, flasin vetë. Është sulmues dhe është mësuar të shënojë gola. Besoj se do të na ndihmojë në sulm dhe të marrim rezultatet më të mira të mundshme", ka deklaruar ai.



Brooklyni rrezikon 'play-off'-in, fitojnë Milwaukee dhe Denveri

LOS ANXELOS, 7 SHKURT - Kampionët e Milwaukee Bucksit fituan me rezultat 137-113 ndaj Clippersave, duke luftuar për kreun e renditjes në Konferencën e Lindjes. Ndeshje e dominuar nga miqtë, ku u dallua Antetokounmpo, autor i 28 pikëve, 10 reboundeve, mbështetur edhe nga Holiday me 27 pikë e 13 asistime. Zhgënjën skuadra e Chicago Bullsit, që u mund me rezultat 119-108 në fushën e saj nga Philadelphia, duke lëshuar kreun në Lindje. Ndeshje fantastike e Joel Embiidit, autor i 40 pikëve e 10 reboundeve,



ndërsa 45 pikët e DeRozanit për vendasit mbetën për statistikë. Fitoi edhe ekipi i Dallasit, që mposhti 103-94 Atlantan, sfidë ku Luka Doniqi realizoi një "triple double" (18 pikë, 10 rebounde, 11 asistime). Gjithsesi, shënuesit më të mirë për Dallasin ishin Bullock e Brunson me nga 22 pikë secili.

Tjetër humbje për Brooklynin, e teta radhazi, duke rrezikuar "play-off"-in. Nets u mund 124-104 nga Denveri, Kyrie Irving realizoi 27 pikë për Brooklynin, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen, ndërsa për Denverin u dallua Nikola Jokiqi me një "triple double" (27 pikë, 12 rebounde, 10 asistime).

REZULTATET

Chicago - Philadelphia	108-119
Minnesota - Detroit	118-105
Denver - Brooklyn	124-104
Cleveland - Indiana	98-85
Orlando - Boston	83-116
Dallas - Atlanta	103-94
Houston - New Orleans	107-120
Clippers - Milwaukee	113-137

Aguero: Kur më futën vetëm në një dhomë të vogël, e kuptova që diçka nuk shkonte

BARCELONË, 7 SHKURT - Sergio Aguero ka folur për herë të parë për problemin në zemër i cili e detyroi të pensionohej nga futbolli para kohe dhe çastin kur e kishte kuptuar se problemi ishte shumë serioz. Aguero u detyrua t'i varë këpucët në gozhdë papritmas në vjeshtë, vetëm pak muaj pasi i ishte bashkuar Barcelonës nga Manchester City si lojtar i lirë. Dhe, duke folur për herë të parë që prej se i dha fund karrierës, Aguero shpjegoi se si e përballoi një çast kaq të frikshëm në jetën e tij. Sulmuesi argjentinas përjetoi vështirësi në frymëmarrje dhe shtrëngim në gjoks në një ndeshje të Barçës kundër Alavesit më 30 tetor. Mjekët zbuluan se ai kishte çrregullime me ritmin e rrahjeve të zemrës dhe e këshilluan ta braktisë futbollin profesionist. Aguero i bëri vetëm pesë paraqitje



për katalonasit në të gjitha garat, duke e shënuar një gol. "15 ditët e para ishin të tmershme për mua", ka thënë Aguero. "Kur ndodhi, mendoja se ishte asgjë dhe se do të bëhesha mirë, por kur mbërrita në

spital dhe ata më lanë vetëm në një dhomë të vogël me shumë ekrane përreth meje, e kuptova se diçka e keqe po ndodhte. Pas dy ditëve në spital, fillova të bëhem nervoz", ka shtuar Aguero.

Bottas: Te Mercedesi e kisha 'thikën në fyt'

Pas pesë vjetësh dominim në pistat e Formulës 1, dyshja e Mercedesit, e përbërë nga Lewis Hamiltoni e Valtteri Bottas, është shpërbërë, pasi piloti finlandez do të garojë

me Alfa Romeo Racing sezonin e ri. Në një intervistë për mediet, Bottas ka rrëfyer aventurë e tij te makina kampione e Formulës 1. "Te Mercedesi nuk ishte e lehtë të

garoje, pasi aty duhet gjithnjë maksimumi, fitorja, podiumi, titulli. Ndaj, aty ishte sikur të garoje me thikën të vendosur në fyt dhe kjo nuk të lejon të arsyetosh ashtu si duhet në

pistë", është shprehur Bottas. "Para se të shkoja te Mercedesi e dija që kishte pasur probleme mes Hamiltonit e Rosbergut. Kur Rosbergu vendosi të largohej

nga Mercedesi nuk e kisha kuptuar atë vendim që mori pasi ishte shpallur kampion. Ndërsa sot e kuptoj falë përvojës sime te Mercedesi", ka shtuar Bottas.

SHKURT

Ronaldo mund të ribashkohet sërish me Realin

Gjatë merkatos së verës mund të kemi një transferim të bujshëm. Rrugët e Cristiano Ronaldos dhe Real Madridit mund të ribashkohet sërish. Madrilënët kanë arritur marrëveshje me Kylian Mbappenen që gjatë merkates së verës të kalonte në "Santiago Barnabeu". Nuk mbaron me kaq. Një raportim nga "El Nacional" ka bërë që të gjithë tifozët madrilenë të ëndërrojnë për ta parë idhullin e tyre të luajë përsëri me Realin. "El Nacional" raporton se Florentino Perez nuk e ka hedhur poshtë mundësinë e rikthimit të CR7 në "Santiago Bernabeu", me "Los Blancos" që kërkon të përfitojë nga situata ku CR7 nuk është edhe shumë i lumtur te skuadra angleze e Manchester Unitedit. Këtë sezon me djajtë ylli portugez ka shënuar 14 gola në 24 ndeshje të luajtura në të gjitha garat ku ka marrë pjesë.

Max Parrot fiton Medaljen e Artë tri vjet pasi u diagnostikua me kancer

Max Parrot i Kanadasë fitoi medaljen e artë olimpikë në snowboard – tri vjet pasi u diagnostikua me kancer. Rezultati i tij në garën e dytë prej 90.96 pikësh i dha titullin, me 17-vjeçarin kinez Su Yiming që fitoi medaljen e argjendtë dhe kanadezin Mark McMorris që siguroi medaljen e bronzit. Parrot u diagnostikua në fund të vitit 2018, por në korrik 2019 njoftoi se ishte pa kancer pas 12 raundeve kimioterapie. "Ndihet e mrekullueshme. Kaq shumë kaluan në ato katër vjetët e fundit. Herën e fundit që isha në Lojërat Olimpikë, në Pyeongchang, mora një medalje argjendi, më pas m'u desh ta kaloja kancerin. Ishte një makth – është kaq e vështirë të përshkruaj atë që unë kam kaluar", ka thënë Parrot. "Të kthehem këtu, në Lojërat Olimpikë, përsëri në një podium, por me një medalje të artë, është një ndjenjë e mrekullueshme", ka shtuar atleti.

Pochettino: Messi është lojtari më i mirë në botë

Trajneri i PSG-së, Mauricio Pochettino, nuk ka dyshime se kush është lojtari më i mirë në botë. PSG-ja mposhti me rezultat bindës (1-5) skuadrën e Lilles, derisa Lionel Messi shënoi dhe asistoi në këtë ndeshje. Pas ndeshjes, Pochettino lavdëroi lart Messin, duke e quajtur lojtari më i mirë në botë. "Nuk kam dyshime, Leo është më i miri në botë. Si të gjithë të tjerët, i duhet kohë që të adaptohet. I duhet kohë të gjejë formën më të mirë, pas një muaji që nuk zhvilloi asnjë ndeshje shkak i Covid-19. Është e rëndësishme që Messi të vazhdojë të jetë bashkëpunues", ka thënë Pochettino.

Mane: Më vjen keq për Salahin, jemi shumë krenarë me suksesin e arritur

Një moment krenarie që Sadio Mane nuk do të harrojë kurrë. Sulmuesi i Senegalit, i cili u shpall edhe lojtari më i mirë i turneut, ka meritën e madhe që nuk u demoralizua edhe pse humbi penallti që në minutën e katërt. "Jam shumë krenar. Është një moment i pabesueshëm për të gjithë vendin tonë", ka thënë ylli i Liverpoolit, i cili shkoi të ngushëllonte edhe shokun e klubit, Salah, i cili mbeti në lot dhe nuk pati fatin ta godiste penalltinë për Egjiptin, duke qenë i pesti në radhë: "Më vjen keq për Salahin. E di se si ndihet. Është një zhgënjim i madh për të dhe shkova ta ngushëlloja".



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NJOFTIM

Agjencia Kosovare e Privatizimit Njofton të gjithë ish punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore: "Rilindja-Gazeta", Ndërmarrja "Botuese - Rilindja", "Rilindja-Revistat", "Shërbimet e Përbashkëta", "Zëri i Rinisë", "Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore", "TAN" dhe "Jedinstvo" se Publikimi i Njoftimit për dorëzimin e dokumentacionit me qëllim të hartimit të listës fillestare do të bëhet me datë: **07,08,09,10,11 shkurt 2022**. Njoftimet mund ti gjeni në webfaqen e Agjencisë Kosovare të Privatizimit www.pak-ks.org.



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS

Në bazë të nenit 10, pika 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut, nr.2003/13, me ndryshimet dhe plotësimet e Rreg. së UNMIK-ut, 2004/45, e duke zbatuar Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-16-0268-A0001, dt.24.08.2017, dhe Udhëzimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJSK, nr.C-IV-20-0059, dt.15.10.2020, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), me dt.07.02.2022,

PUBLIKON

NJOFTIMIN për punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) "Rilindja-Gazeta" PRN142, NSH Ndërmarrja "Botuese-Rilindja" PRN181, NSH "Rilindja-Revistat" PRN074, NSH "Shërbimet e Përbashkëta" NP Rilindja PRN185, NSH "Zëri i Rinisë" PRN182, NSH "Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore" PRN071, NSH TAN PRN151, dhe NSH "Jedinstvo" PRN188, me qëllim të aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit të punëtorëve për këto NSH, lidhur me hartimin e Listës fillestare të punëtorëve në formatin tabelar excel për përfitim të një pjese prej 20% të të ardhurave nga privatizimi-likuidimi apo shpronësimi i NSH-ve të theksuara më lartë nga kompetenca e BSPK-së dhe atë:

1. Libreza e punës (për punëtorët që i posedojnë), apo kontratat të punës, para apo pas qershorit 1999,
2. Të ardhurat personale nga Ndërmarrja përkatëse për punëtorët të cilët kanë punuar pas qershorit 1999, deri në privatizimin-likuidimin apo shpronësimin e NSH-ve,
3. Në rast të mungesës së Librezës së punës, çfarëdo dokumenti tjetër (Kontrata apo vendime të punës) që dëshmojnë themelimin e marrëdhënies së punës, përkatësisht përfundimin e punësimit në NSH,
4. Vendimin eventual për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për periudhën 1989-1999, gjatë aplikimit të masave të dhunshme diskriminuese nga ish Kuvendi i Republikës së Serbisë, (nëse posedojnë me këtë vendim),
5. Dokumentet në komunat përkatëse, Dep. për çështje sociale për të rënë në Luftën e Kosovës 1997-1999, goftë luftëtarët e lirisë, por edhe të viktimave civile,
6. Çfarëdo dokumentacioni tjetër i cili dëshmon dhe arsyeton pretendimet për të drejtën e punëtorëve për t'u përfshirë në Listën fillestare në formatin tabelar excel që do të hartohet nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës në konsulencë me menagjmentin dhe sindikatat e NSH-ve përkatëse.
7. Ekstrakti i lindjes dhe kopjet e lejes së njoftimit
8. Numrat e tel. kontaktues.


Të gjitha dokumentet që do të dorëzohen duhet të jenë të noterizuara nga noteri kompetent përveç lejes së njoftimit.

Dokumentacioni dorëzohet në Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës-Zyra e Ekspertit Ligjor të BSPK-së për Listat fillestare të punëtorëve për 20% në Hotelin GRAND, kati III, Prishtinë, personalisht apo përmes postës.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit të punëtorëve është 20 ditë nga data e publikimit të njoftimeve sipas dispozitivit -1, të Udhëzimit të DHPGJSK, C-IV-20-0059, dt.15.10.2020.

OBAVEŠTENJE

Kosovska agencija za privatizaciju obaveštava sve bivše radnike društvenih preduzeća: "Rilindja-Novine", "Izdavačko - Rilindja" preduzeće, "Rilindja - Časopisi", "Zajedničke usluge", "Glas omladine", "Zavod za udžbenike i nastavna sredstva", "TAN" i "Jedinstvo" da objavljivanje Obaveštenja o dostavljanju dokumentacije radi sastavljanja početnog spiska biće izvršeno dana **07,08,09,10,11. februara 2022. godine**. Obaveštenja možete naći na veb stranici Kosovske agencije za privatizaciju www.pak-ks.org.



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS

Na osnovu odredbe člana 10, tačka 10.2, UNMIK Pravilnika, br.2003/13, sa izmenama i dopunama UNMIK Pravilnika, br.2004/45, i Rešenje Posebne Komore Vrhovnog Suda Kosova, br.AC-I-16-0268—A0001, od. 24.08.2017, i Upustvo Specializovano Veće Posebne Komore Vrhovnog Suda Kosova, br. C-IV-20-0059, od 15.10.2020, Unija Nezavisnih Sindikata Kosova (UNSK), dana, 07.02.2022,

JAVNO OBJAVLJUJE

POZIV za prijavu radnika Društvenog Preduzeća (DP) "Rilindja-Novine" PRN142, DP "Izdavačko-Preduzeće "Rilindja" PRN181, DP "Rilindja-Časopisi" PRN074, DP "Zajedničke Službe" NP Rilindja PRN185, DP "Zeri i Rinise" PRN182, DP "Zavod za Udžbenike i Nastavna Sredstva" PRN071, DP TAN-PRN151 i "Jedinstvo" PRN188, radi dostavljanja dokumentacije radnika ovog DP-a, za izradu osnovne liste radnika u tabelarnom formatu excel za dobijanje dela Prihoda od 20, od privatizacije-likvidacije ili eksproprijacije gore pomenutog DP-a, iz nadležnosti UNSK, i to:

1. Radne knjizice (za radnike koji ih poseduju), ili Ugovor o radu nakon juna 1999.god.
2. Lični dohodak od DP-a za radnike koji su radili nakon juna 1999, do privatizacije-likvidacije ili eksproprijacije DP-a,
3. U slučaju nedostatka Radne knjizice, bilo koji drugi dokument (Ugovori o radu ili rešenje o radnom odnosu kojim se dokazuje zasnivanje ili završetak radnog odnosa u DP-u,
4. Odluku-Rešenje o prestanku radnog odnosa tokom 1990-1999.god. za vreme diskriminatorskih prinudnih mera uvođene od bivše Skupštine Republike Srbije (ukoliko ih poseduju iste),
5. Dokumente u odgovarajućim opštinama za poginule u ratu na Kosovu 1997-1999.god., bilo za borbu za slobodu ili civilne žrtve,
6. Bilo koju drugu dokumentaciju koja dokazuje i obrazlaže zahtev o pravu radnika za uključnje u početnom spisku u excel formatu, koju izradjuje Unija Nezavisnih Sindikata Kosova u saradnji sa upravnikom i sindikat DP-a.
7. Izvod rođeni, i fotokopje lične karte, i
8. Broj telefona

Celokupna dostavljena dokumentacija od strane radnika treba overiti kod nadležnog notara.

Dokumentacija radnika dostavlja se na adresu: Unija Nezavisnih Sindikata Kosova (UNSK), Kancelarija Pravnog Eksperta UNSK za početne Liste radnika za 20%, u Grand Hotel, III-sprat, u Prištini, lično ili preko pošte.

Rok za dostavljanje dokumentacije radnika je 20 dana od dana objavljivanja na osnovu dispozitiva-1, Upustva Posebne Komore Vrhovnog Suda Kosova, C-IV-20-0059, dt.15.10.2020.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Në bazë të nenit 67 dhe 68 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 90/2010), Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit administrativ nr. 05/2021, Udhëzimit administrativ nr. 02/2018 për Qendrat Burimore, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe kërkesave të Qendrës Burimore, Departamenti i arsimit parauniversitar, shpall;

KONKURS

Për vendin e lirë të punës në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nënë Tereza” Prizren

Nr.	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Nr. i pozitive
1	Instruktur i gjuhës së shenjave në QB “Nënë Tereza” në Prizren (rishpallur)	vend i lirë	1
2	Asistent i gjuhës së shenjave në QB “Nënë Tereza” në Prizren	vend i lirë	3

I. Punët dhe detyrat krvesore të instruktorit/es së gjuhës së shenjave

- Mbështet nxënësit dhe stafin e QB për gjuhën e shenjave;
- Ofron kurse të gjuhës së shenjave për stafin e QB dhe prindërit e nxënësve;
- Bashkëpunon me menaxherin dhe stafin e QB në promovimin e gjuhës së shenjave;
- Në bashkëpunim me stafin harton materiale për QB në gjuhën e shenjave.

1. Përgatitja shkollore për Instruktur të gjuhës së shenjave

- Niveli baçelor – trajnimi për gjuhën e shenjave me 120 kredi (ECTS).

II. Punët dhe detyrat krvesore të Asistentit/es të gjuhës së shenjave

- Drejtpërdrejtë merr pjesë në aktivitete arsimore dhe jashtë arsimore;
- Mbështet nxënësit në klasë në mësimin e gjuhës së shenjave;
- Mbikëqyrë dhe ndihmon fëmijët/nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike/personale, mjekësore dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre nëse ata kanë nevojë;
- Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim në gjuhën e shenjave dhe pjesëmarrje në lojë
- Mbështetë nxënësit në punën praktike;
- Bashkëpunon me mesimdhënësit dhe edukatorët në përgatitjen e materialeve në gjuhën e shenjave.

2. Përgatitja shkollore për Instruktur të gjuhës së shenjave

- Arsimiti mesëm
- Certifikatë mbi kryerjen e trajnimit për gjuhën e shenjave me 120 kredi (ECTS).

Kushtet e konkursit

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e Ligjeve që e rregullojnë fushën e arsimit: paragrafi 5 i nenit 35 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, paragrafët 7 dhe 9 të nenit 8 të Udhëzimit administrativ 05/2021 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm.

Sqarim shtesë: – Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuar dokumentet në MASHTI.

Në intervistë me shkrim ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit.

Kandidatët që aplikojnë duhet të jenë banor të Republikës së Kosovës.

Afati dhe mënvra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik. Formulari i aplikimit (merret në Qendër Burimore). Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë). Diploma e kualifikimit (ose certifikatë) certifikata në vend të diplomës duhet të jetë e noterizuar. Kandidatët, dokumentet duhet ti dorëzojnë në Qendrën Burimore/shkollën speciale përkatëse ku konkurrojnë. Aplikacionet e pakompletuara nuk shqyrtohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit- Ministarstvo Obrazovanja Nauke Tehnologije i Inovacije- Ministry of Education, Science and Technology

Na osnovu člana 67 i 68 Zakona br. 06 / L-114 o javnim službenicima član 8 stav 1 i 2 Zakona o radu br. 03/L-212, (Službeni glasnik Republike Kosovo, br. 90/2010), Zakon br. /L-032 o predniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo, Administrativno uputstvo br. 05/2021, Administrativno uputstvo 02/2018 o Resursnim centrima, Administrativno uputstvo br. 07/2017 o regulisanju procedure konkurisanja u javnom sektoru i zahtevima Resorsnih centra, Departament za preduniverzitetsko obrazovanje objavljuje;

KONKURS

Za slobodna radna mesta u Resorsnim centrima za nastavu i savetovanje" Majka Tereza" u Prizren

Br.	Položaj:	Slobodno radno mesto/zamena	Br. pozicija
1	Instruktur znakovnog jezika u RC "Majka Tereza" u Prizren (obnavlja)	slobodno radno mesto	1
2	Asistent znakovnog jezika u RC "Majka Tereza" u Prizren	slobodno radno mesto	3

I. Glavni zadaci i obaveze Instruktor/ke znakovnog jezika:

- Podržava učenike i osoblje RC u znakovnom jeziku;
- Omogućava kurseve znakovnog jezika za osoblje RC i roditelje učenika;
- Saraduje sa menadžerom i osobljem RC u promociji znakovnog jezika;
- U saradnji sa osobljem sastavlja materijale za RC na znakovnom jeziku.

1. Školska sprema za Instruktor znakovnog jezika

- Nivo bachelor– obuka znakovnog jezika sa 120 kredita (ECTS).

II. Glavni zadaci i obaveze Asistent/ke znakovnog jezika:

- Neposredno učestvuje u obrazovnim i vannastavnim aktivnostima;
- Podržava učenike u učionici u učenju znakovnog jezika;
- Nadgleda i pomaže deci/učenicima tokom obroka, brine o fizičkim/ličnim, medicinskim potrebama i pomaže u njihovom odevanju i opštoj čistoći ako im je potrebno;
- Promoviše inkluzivno obrazovanje i prijem sve dece u učionicu, podstiče decu da komuniciraju na znakovnom jeziku i učestvuju u igri
- Podržava učenike u praktičnom radu;
- Saraduje sa nastavnicima i vaspitačima u pripremi materijala na znakovnom jeziku.

2. Školska sprema za Instruktor znakovnog jezika

- Srednje obrazovanje
- Certifikat o završenom treningu znakovnog jezika sa 120 kredita (ECTS)

Uslovi konkursa

Izbor kandidata vrši se na osnovu kriterijuma zakona koji regulišu oblast obrazovanja: stav 5. člana 35. Zakona br. 04 / L-032 o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo, stav 7 i 9 člana 8 Administrativnog uputstva 05/2021 o Normativu stručnog kadra opšteg obrazovanja.

Dodatno objašnjenje: -Informacije prikazane u aplikaciji smatraju se validnim samo u koliko budu potkrepljeni dokazom

Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju dostaviti da je izvršena nostrifikacija dokumenta od strane MONTI-a.

Na pismenom intervju će biti pozvani samo kandidati koji ispunjavaju kriterije konkursa.

Kandidati koji apliciraju moraju biti stanovnici Republike Kosovo.

Rok i način apliciranja

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od objave konkursa u medijima javnog informisanja.

Formulara za aplikaciju (može se dobiti u Resornom Centru).

Lični dokument (lična karta ili pasoš).

Diploma kvalifikacije (ili certifikat) certifikat umesto diplome mora biti noterizovan;

Kandidati, dokumenta trebaju predati u relevantni Resursni centar / Specijalnu školu u kojoj konkurišu. Ne kompletirane aplikacije neće se uzeti na razmatranje.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Hajret Bytyqi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Nasuf Rasimi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Berat Kalimashi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Ardian Koshi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Mati Logoreci " Prizren.
- ▶ Nikollë Nreca, Doli KK Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U "Anton Çeta" Kk Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.
- ▶ Donjeta Hasani Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën kl. X,XI,XII,XIII si dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

